Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Zyra për Komunikim me Publikun

02 01-052/01-0058018/26
Nr i Ref./Br.
Data/Datum 02.10.2026
Mitrovicë - Mitrovica

Raport për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike Janar- Shtator 2026

Regjistri i evidencës së kërkesave të pranuara dhe përgjigjeve të dhëna për qasje në dokumentet publike të Komunës së Mitrovicës duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2023/2027.

Gjatë kësaj periudhe nëntë mujore Janar- Shtator 2026, Zyra për Komunikim me Publikun, konkretisht Zyrtarja Përgjegjëse për Qasje në Dokumente Publike ka pranuar gjithsej **87** kërkesa për qasje në dokumente publike, ku **79** prej tyre janë parashtruar në formë elektronike dhe **8** në formë fizike.

Të gjitha kërkesat e parashtruara për Komunën e Mitrovicës kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë ligjor, ku **66** prej tyre kanë marrë qasje të plotë, ndërsa **15** qasje të pjesshme, **1** është anuluar, **1** është tërhequr pala, **1** është refuzuar pjesërisht dhe **3** janë në proces.

Të dhënat në formë të detajuar për secilën kërkesë për këta nëntë muaj mund ti gjeni në tabelat e mëposhtme.

Nr.	Parashtruesi i kërkesës	Mënyra e parashtrimit të kërkesës	Data e parashtrimit	Data e dërgimit tek drejtoria/ zyrtari përkatës për	E vlerësuar si:	Data e kthimit të përgjigjes	Numri i dokumenteve të kërkuara

				vlerësimin e qasjes			
1.	Organizata DYVO-Development Youth Voices Organization 01-034/01-0078166/26	Elektronike	29.12.2025	29.12.2025	Qasje e Plotë	12.01.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike dhe informata lidhur me Listën e Pronave Komunale me statusin aktual të tyre; për pronat që janë të alokuara për përdorim të gjatë (pronat e dhëna për shfrytëzim të gjatë) dhe për secilën pronë të tillë kërkohet kopje e dokumentit ligjor që vendos statusin (kontratë, memorandum mirëkuptimi, vendim i Kuvendit Komunal, akt tjetër ligjor) dhe Vendimet administrative apo të Kuvendit Komunal për dhënie të pronës publike për përdorim (shfrytëzim) si vendime të Kuvendit Komunal, vendime të zyrtarëve kompetent dhe referenca dokumentesh.
2.	Jahir Sumiçi, gazetar në "HulumTime Media" 01-034/01-0002517/26	Elektronike	14.01.2026	14.01.2026	Qasje e Plotë	16.01.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente publike në lidhe me emërimin e Asistentes/it të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe atë: a është bërë emërimi, nëse po me cilën datë, emrin e të emëruarit dhe cila ka qenë procedura e ndjekur për këtë emërim.
3.	Enis Veliu, gazetar në FrontOnline Sh.P.K 01-034/01-0002606/26	Elektronike	15.01.2026	15.01.2026	Qasje e Plotë	22.01.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me Listën e Pronave të Komunës së Mitrovicës së Jugut të cilat janë dhënë me qera afatshkurtër dhe afatgjatë për individ apo kompani të ndryshme, në mënyrë të veçantë ka kërkuar që lista të përmbaj këto të dhëna: Prona-përshkrimi/lloji i pronës, sipërfaqja dhe vendndodhja (adresa/lagjja)" qiramarrësi i pronës- emri i individit ose kompanisë.

4.	Jahir Sumiçi, gazetar në "HulumTime Media" 01-034/01-0003094/26	Elektronike	18.01.2026	19.01.2026	Qasje e Plotë	22.01.2026	Kërkesa e palës ka të bëjë me procedurën e prokurimit publik me titull: "Furnizim me pajisje dhe pjesë të imta për mirëmbajtjen e objekteve", Nr. I Prokurimit: 642-25-9859-1-2-1, datë: 24.12.2025, Autoritet Kontraktues: Komuna e Mitrovicës së Jugut. Nga njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues rezulton se operatori ekonomik LEMKOS SH.P.K. është shpallur fitues i kontratës. Lidhur me këtë, ju lutem të na ofroni këto informata dhe dokumente: Numrin unik të biznesit (NUI/NUB) të operatorit ekonomik LEMKOS SH.P.K., si dhe dëshminë zyrtare për regjistrimin e tij si biznes aktiv, duke pasur parasysh se nga verifikimi në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) ky emër nuk figuron si biznes i regjistruar. Arsyetimin zyrtar të vlerësimit të ofertave, duke qenë se operatori i shpallur fitues nuk ka ofertën me çmimin më të ulët, ndonëse kjo ka qenë kërkesë e përcaktuar në dokumentacionin e tenderit. Raportin e komisionit vlerësues dhe procesverbalin e vlerësimit të ofertave, nëse ekzistojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5.	Ylli Bokshi, Avokat 01-034/01-0003341/26	Elektronike	19.01.2026	20.01.2026	Qasje e Plotë	22.01.2026	Pala ka kërkuar qasje në të dhëna zyrtare të kontaktit për organin e kujdestarisë dhe Qendrën për Punë Sociale. Konkretisht, numrat zyrtarë të telefonit, adresat elektronike email dhe adresat fizike të institucioneve përkatëse.

6.	Tirana Bytyqi, gazetare në Organizatën "Çohu" 01-034/01-0004468/26	Elektronike	26.01.2026	26.01.2026	Qasje e Plotë	30.01.2026	Pala ka kërkuar informacionet lidhur me vërshimet që kanë ndodhur si pasojë e reshjeve të shumta të shiut, dhe lidhur me procedurat dhe masat për dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.
7.	Endrit Berani, 01-034/01-0004853/26	Elektronike	26.01.2026	27.01.2026	Qasje e Pjesshme	30.01.2026	Pala ka kërkuar qasje në informacionin nëse Komuna e Vushtrrisë është ende aksionare në shoqërinë aksionare me përgjegjësi të kufizuar KRM "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë (Kompania Rajonale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A.), si dhe kopje të dokumenteve relevante që e vërtetojnë këtë status aktual, të tilla si: Regjistri aktual i aksionarëve të shoqërisë; Vendimet e Kuvendit Komunal ose organeve të tjera vendimmarrëse për ndryshime në strukturën e aksionarëve (nëse ka pasur ndryshime nga themelimi deri më sot); Statuti i shoqërisë, marrëveshja themeluese ose çdo dokument tjetër që përcakton pronësinë aksionare; Çdo raport, vendim apo korrespondencë zyrtare që konfirmon ose përjashton pjesëmarrjen e Komunës së Vushtrrisë si aksionare.
8.	Portali "Jepizë Media" 01-034/01-0005524/26	Elektronike	30.01.2026	30.01.2026	Qasje e Plotë	11.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike në procesverbalin e këtij inspektimi, vendimin e nxjerrë nga ky inspektim, si dhe të gjithë dokumentacionin e dosjes së lejes për ndërtimin e këtij kompleksi banesor. Me 27 janar 2026, Inspektorati i Komunës së Mitrovicës ka ndërmarrë një aksion për vendosjen e shiritave në një kompleks banesor në rrugën "Liqeni" të kompanisë "AZ Building". 3. Pyetje- Duam të dimë çfarë shkelje keni gjetur saktësisht në vendin e ngjarjes? Në cilën dispozitë ligjore jeni bazuar për vendosjen e shiritave për ndaljen e përkohshme të punimeve? A e parasheh ligji që të vendosen shiritat në punishte, edhe në raste kur ka vonesa në pagesën për këstet e lejes së ndërtimit?

							A mund të na dërgoni procesverbalin e inspektimit? Sipas ligjit, për sa kohë parashihet ndalja e punimeve në këto raste? Për çfarë arsye kanë dalë në vendngjarje edhe zyrtarë që nuk janë inspektorë të ndërtimit?
9.	Jahir Sumiçi, përfaqësues i Medias "HulumTime" 01-034/01-0006151/26	Elektronike	03.02.2026	03.02.2026	Qasje e Plotë	23.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe të dhëna zyrtare në lidhje me; Emrat e shkollave që aktualisht nuk kanë drejtor, Emrat e shkollave që nuk kanë zëvendësdrejtor, Emrat e shkollave që udhëhiqen nga ushtrues detyre, si dhe periudhën kohore të ushtrimit të këtij funksioni, Emrat e shkollave që kanë mungesë të mësimdhënësve, Emrat e shkollave që kanë psikolog shkolle, Emrat e shkollave që nuk kanë psikolog shkolle, Emrat e shkollave që nuk kanë pedagog shkolle, Emrat e shkollave që nuk kanë sekretar shkolle dhe Emrat e shkollave që nuk kanë personel ndihmës (shtëpiak/mirëmbajtës).
10	Behar Syla 01-034/01-0007646/26	Fizike	09.02.2026	Zyrtarja përgjegjëse për qasje në dokumente publike me datë 11.02.2026 ka pranuar kërkesën dhe në të njëjtën datë është përcjell tek Njësia Përgjegjëse .	Qasje e Pjesshme	16.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me të dhe vajzën e tij, sipas dispozitave që i parasheh ligji.

11	"DioBes" Sh.P.K 01-034/01-0008043/26	Elektronike	11.02.2026	11.02.2026	Qasje e Pjesshme	16.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike në lidhje me tenderin me titull: Asfaltimi i rrugëve në Bajgorë, Rashan, Tërstenë, Kutllovc dhe Vllahi – Komuna e Mitrovicës së Jugut në Bashkëfinancim me MMPHI 642-25-5633-5-1-1.
12	Edona Meholli, gazetare në "Veriu.info" 01-034/01-0008278/26	Elektronike	11.02.2026	11.02.2026	Qasje e Plotë	16.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në përgjigje për uzurpim të parkingut publik në rrugën 'Nexhip Dragaj' me material ndërtimor nga Aurora Group, konkretisht qasje ne dokumente publike në: 1) Vendimin/et e marra nga Drejtoria e Inspeksionit për këtë rast. 2) Gjobën dhe shkresat e tjera te lendes nëse ka për këtë rast.
13	Marigona Mehani "Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve" 01-034/01-0008708/26	Elektronike	13.02.2026	13.02.2026	Qasje e Plotë	20.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në lidhje me inicimin e procedurës për trajtimin e qenve agresivë, më konkretisht: Çfarë lloj procedure është iniciuar, pasi që në sistemin e-prokurimi nuk figuron një aktivitet i tillë? Mbi çfarë baze ligjore është duke u zhvilluar kjo procedurë dhe nga cili operator ekonomik, dhe çdo informacion tjetër rreth kësaj procedure?
14	Laurant Berisha, "BIRN" 01-034/01-0008643/26	Elektronike	13.02.2026	13.03.2026	Qasje e Pjesshme	20.02.2026	Pala përmes pyetësorit ka kërkuar nga Komuna e Mitrovicës qasje në informacione lidhur me zbatimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028, me theks të veçantë në 'Parandalimin' si objektiv strategjik dhe qëllimi specifik, si në vijim: 1.Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja e hershme për parandalimin e radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm. Pyetjet e këtij pyetësori synojnë të evidentojnë ndryshimet, përparimet apo sfidat e reja që kanë ndodhur nga nëntori 2024 e deri më 31 tetor 2025.

15	Flora Çekaj U.D Udhëheqëse e Sektorit Ligjor-NP IHK "INFRAKOS" Sh.A Fushë Kosovë 01-034/01-0009928/26	Elektronike	23.02.2026	23.02.2026	Qasje e Pjesshme	27.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në dëshminë e vdekjes së të padituërs që të identifikojnë trashëgimtarët.
16	Avokate Fitore Troshupa- Maloku 01-034/01-0012509/26	Elektronike	05.03.2026	05.03.2026	Qasje e Pjesshme	09.03.2026	Pala ka kërkuar të pajiset me kopje zyrtare të raporteve, procesverbaleve dhe çdo dokumentacioni relevant lidhur me rastin e një qytetareje nga Qendra për Punë Sociale.
17	Rizah Avdiu 01-034/01-0012751/26	Elektronike	09.03.2026	09.03.2026	Qasje e Plotë	13.03.2026	Pala ka kërkuar qasje në letër reference në lidhje me tenderin furnizimi dhe instalimi me materiale elektrike në objektin Qendra për mbrojtjen e dhunës në familje me numër të prokurimit 642-24-10762-1-3-6.
18	Jahir Sumiçi, gazetar në HulumTime Media 01-034/01-0012483/26	Elektronike	07.03.2026	08.03.2026	Qasje e Plotë	13.03.2026	Pala ka kërkuar sqarim dhe qasje në dokumente lidhur me procesin e përzgjedhjes së "Mësimdhënësit të Dalluar" në Komunën e Mitrovicës së Jugut për vitin shkollor 2025/2026.
19	Mirselda Kile Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon	Elektronike	11.03.2026	11.03.2026	Qasje e Pjesshme	17.03.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike si; Urdhri i emërimit të Kryetarit dhe Karta e identitetit të Kryetarit.

	01-034-01-0013180/26						
20	Liridon Demiraj, inxhinier i Hidroteknikës, Komuna e Istogut 01-034/01-0015494/26	Elektronike	24.03.2026	25.03.2026	Qasje e Plotë	27.03.2026	Pala ka kërkuar qasje në një kopje të skanuar të vendimit për lëshimin e lejes ndërtimore për projektin e qendrës tregtare "Art Mall" në Mitrovicë.
21	Uvejs Gashi, avokat nga Mitrovica 01-08-034/01-0016759/26	Fizike	31.03.2026	01.04.2026	Qasje e Plotë	20.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me projektin e investitorit Arsi Company dhe atë të gjitha dokumentet që posedon DPU, përfshirë aplikimin për leje ndërtimi, lejen e ndërtimit, kontrollet e inspektorëve komunal gjatë fazës së ndërtimit, raportet e lëshuara nga inspektorët, aplikimin për pranim teknik, raportet për pranim teknik, vendimin për pranimin teknik dhe çdo dokument tjetër të kësaj natyre që lidhen me objektin e ndërtuar nga investitori.
22	Jahir Sumiçi, gazetar në HulumTime Media 01-034/01-0017359/26	Elektronike	01.04.2026	02.04.2026	Qasje e Plotë	07.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata lidhur me zëvendësimin e Ramadan Beshiri, i cili ishte profesor i lëndës së sociologjisë në SHML "Hasan Prishtina" dhe tani është emëruar në pozitën e Drejtorit për Mirëqenie Sociale, konkretisht; A ka ndërmarrë Drejtoria Komunale e Arsimit masa për zëvendësimin e profesorit në fjalë? 2. Nëse PO: o Kush është personi i angazhuar si zëvendësim? • Cilat janë kualifikimet profesionale dhe akademike të tij/saj? O Në çfarë baze ligjore dhe kontraktuale është bërë ky angazhim? 3. Nëse JO:

							o Cilat janë arsyet e mos zëvendësimit? O Si është duke u garantuar zhvillimi i rregullt i procesit mësimor për nxënësit?
23	OJQ- REC- Reconciliation Empowering Communities 01-034/01-0017484/26	Elektronike	02.04.2026	02.04.2026	Qasje e Plotë	08.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike përkatësisht informacione në lidhje me punësimin dhe qasjen në institucione për persona me aftësi të kufizuara duke bashkëngjitur pyetësorin me pyetje konkrete si: Numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar në Komunë, politikat dhe masat e ndërmarra për punësim gjatë vitit 2025, nivelin e qasjes fizike në objektet komunale, shërbimet dhe format e përfshirjes për personat me aftësi të kufizuara.
24	Vigan Behluli 01-034/01-0017836/26	Elektronike	03.04.2026	03.04.2026	Qasje e Plotë	07.04.2026	Pala ka kërkuar dokumente dhe informata lidhur me Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2020- 2028.
25	Jahir Sumiçi, gazetar në HulumTime Media 01-034/01-0017796/26	Elektronike	02.04.2026	02.04.2026	Qasje e Pjesshme	08.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike, konkretisht ka kërkuar që të njoftohet paraprakisht dhe në mënyrë të vazhdueshme për takimet dhe aktivitetet zyrtare të kryetarit të komunës, aktivitetet dhe vizitat e nënkryetarit, organizimet, vendimet dhe njoftimet e drejtorive komunale, ngjarjet dhe zhvillimet me interes publik për qytetarët, mbledhjet e komisioneve komunale në të gjitha rastet kur ato janë të hapura për publikun dhe mediat.
26	Jahir Sumiçi 01-034-01-0019709/26	Elektronike	12.04.2026	14.04.2026	Qasje e Plotë	17.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente dhe informacion zyrtar lidhur me projektin e ndërtimit të çerdhes në lagjen Tavnik.
27	Vanesa Isufi 01-034/01-0019748/26	Elektronike	14.04.2026	14.04.2026	Qasje e Pjesshme	17.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata apo dokumentet ku dëshmohet arsyeja e mos pagesës së plotë të pagës së muajit Gusht 2025.

28	Jahir Sumiçi, HulumTime Media 01-034-01-0020870/26	Elektronike	16.04.2026	17.04.2026	Qasje e Plotë	21.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente në lidhje me deklarimin publik të Drejtorit për Mirëqenie Sociale, Ramadan Beshiri, se gjatë periudhës tre mujore është shënuar një ulje prej 2.94% e numrit të familjeve përfituese të asistencës sociale; Numrin e saktë të familjeve përfituese të asistencës sociale për vitin 2025 (i ndarë sipas muajve, nëse është e mundur); Numrin e familjeve përfituese për tre mujorin e parë të vitit 2026; Paraqitjen grafike (grafikonin) e ndryshimit të përqindjes së familjeve përfituese, duke reflektuar trendin e rënies së raportuar; Sqarimet zyrtare mbi shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në këtë ulje, duke përfshirë politikat, vendimet administrative apo ndryshimet në kriteret e përfitimit.
29	Redaksia "Mitropol Media" 01-034/01-0020876/26	Elektronike	16.04.2026	16.04.2026	Qasje e Plotë	21.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike dhe atë skicën e planifikimit urbanistik për lagjet "Nexhip Dragaj", "Ferat Dragaj" dhe "Ukshin Kovaqica".
30	Jahir Sumiçi, gazetar në HulumTime Media 01-034/01-0020874/26	Elektronike	16.04.2026	16.04.2026	Qasje e Plotë	08.05.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente publike në lidhje me deklarimet publike për angazhimin e këshilltarëve të jashtëm në Drejtorinë e Shëndetësisë, kërkojmë nga Komuna e Mitrovicës së Jugut të na ofrojë informacionet si më poshtë: Dokumentin zyrtar (vendim/kontratë/akt administrativ) mbi bazën ligjore të angazhimit të këshilltarëve të jashtëm në Drejtorinë e Shëndetësisë; Listën e drejtorive komunale që kanë angazhuar këshilltarë të jashtëm (nëse ka më shumë se një drejtori);

							Emrat dhe mbiemrat e të gjithë këshilltarëve të jashtëm të angazhuar në secilën drejtori veç e veç; Pozitën/fushën e secilit këshilltar të angazhuar; Datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontratës së secilit angazhim; Vlerën financiare të kontratës ose kompensimin mujor për secilin këshilltar.
31	Hasan Dervari, "Gazeta Online" Prishtinë 01-034/01-0021481/26	Elektronike	17.04.2026	17.04.2026	Qasje e Plotë	08.05.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me marrëveshjen e Komunës së Mitrovicës me Fondin Kosovar të Efiçiencës nëse po, Sa është shuma e marrëveshjes, sa ka përfituar komuna nga këto marrëveshje, a ka person kontaktues që mbikëqyr punën e tyre, sa ka obligime komuna ndaj Fondit.
32	Arbnora Pllana, gazetare në Kosova Press 01-034-01-0021972/26	Elektronike	21.04.2026	21.04.2026	Qasje e Plotë	24.04.2026	Pala ka kërkuar informacione në lidhje me kamerat e sigurisë të vendosura në hapësirat publike të Komunës së Mitrovicës së Jugut, procedurat e tenderimit për këtë projekt, si dhe kompaninë fituese.
33	Edona Meholli, gazetare në Veriu.info 01-034/01-0022236/26	Elektronike	22.04.2026	22.04.2026	Qasje e Plotë	24.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në; Lejen e lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit për kompleksin banesor që po ndërtohet nga Xani Exclusive Building në lagjen Bair. Gjitha shkresat që ndërlidhen me lejen, para dhe pas lëshimit të saj.
34	Gazmend Morina, Gazetar në Veriu.info 01-034/01-0026252/26	Elektronike	06.05.2025	06.05.2026	Qasje e Pjesshme	08.05.2026	Pala ka kërkuar qasje në; 1) Dosjen e tenderit për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Bajgorë, Rashan, Tërstenë, Kutllovc dhe Vllahi. 2) Gjithë dosjen e ofertimit nga grupi i operatorëve ekonomike Dio Bes Sh.P.K. dhe Eurokos Holding Sh.P.K. Këtu përfshihet edhe qasje në dokumentet aplikuese për stafin e tyre, përfshirë edhe diplomat e stafit,

							kontratat me stafin, si dhe referencat e këtij grupi të operatorëve ekonomik për punët qe i ka kryer në te kaluarën dhe që i ka përdorur si reference për aplikim. Për shkak se ne aplikim ka përdorur si staf shtetas te huaj, për ne është me rendësi t'i kemi gjitha shkresat për ta, në mënyre që të sqarohet çështja e nostrifikimit te diplomave te tyre.
35	Jahir Sumiçi, Gazetar në HulumTime Media 01-034/01-0027593/26	Elektronike	10.05.2026	13.05.2026	Qasje e Pjesshme	28.05.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente zyrtare lidhur me orët mësimore të drejtorëve të emëruar në komunë, të cilët paraprakisht kanë qenë të angazhuar si mësimdhënës në institucionet arsimore.
36	Jahir Sumiçi, gazetar në HulumTime Media 01-034/01-0031030/26	Elektronike	30.05.2026	01.06.2026	Qasje e Plotë	08.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata në lidhje me kompensimin e mjekëve në angazhimet e tyre për kujdestari dhe atë; A janë kompensuar mjekët për kujdestaritë e realizuara në QKMF "Nexhat Çuni"; Nëse jo, cilat janë arsyet konkrete të mos kompensimit; Sa muaj kanë mbetur pa u ekzekutuar pagesat; Kur pritet të realizohen këto obligime financiare ndaj stafit mjekësor.
37	Gazmend Morina, Gazetar në Veriu.info 01-034/01-0034036/26	Elektronike	11.06.2026	12.06.2026	Qasje e Plotë	16.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në; 1) Vendimet për ndërprerje të punimeve për "Afri Univerzal", "FINN AB Group" dhe "Aurora Group", 2) Procesverbalet e inspektimeve të këtyre tre rasteve.
38	Edona Meholli, Gazetare në Veriu.info	Elektronike	10.06.2026	12.06.2026	Qasje e Plotë	16.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në: 1) Vendimet për ndërprerje të punimeve për "Xani" dhe "Berani Group",

	01-034/01-0034034/26						2) Procesverbalet e inspektimeve të këtyre dy rasteve.
39	Jahir Sumiçi, Kryeredaktor në HulumTime Media 01-034/01-0034597/26	Elektronike	15.06.2026	16.06.2026	Qasje e Plotë	22.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet dhe të dhënat në vijim: 1.Raporti i plotë buxhetor për Çerdhen e Qytetit, shkollat fillore dhe shkollat e mesme në Komunën e Mitrovicës, sipas buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2025 për vitin fiskal 2026. 2.Raporti i plotë financiar dhe buxhetor aktual për këto institucione pas të gjitha ndryshimeve, transferimeve apo ridestinimeve buxhetore të bëra gjatë vitit 2026. 3.Vendimet, procesverbalet, propozimet, kërkesat apo aktet administrative që kanë shërbyer si bazë ligjore dhe procedurale për transferimin, zvogëlimin apo ridestinimin e mjeteve financiare të institucioneve edukativo-arsimore. 4.Tabelën krahasuese të buxhetit fillestar dhe buxhetit aktual për secilën çerdhe, shkollë fillore dhe shkollë të mesme, duke paraqitur qartë shumën e mjeteve të larguara, të transferuara apo të shtuara. 5.Të dhënat mbi destinimin përfundimtar të mjeteve të transferuara, përfshirë drejtoritë, projektet dhe kategoritë buxhetore që kanë përfituar nga këto mjete.
40	Hasan Dervari Gazeta Online-Prishtinë 01-034/01-0035216/26	Elektronike	17.06.2026	18.06.2026	Qasje e Plotë	23.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në; 1. Në kuadër të institucionit tuaj a ka persona që janë në pushim mjekësor 2. A ka zyrtar në pushim të lehonisë 3. A ka zyrtar në pushim pa pagesë Kërkesa ka të bëjë me të gjitha institucionet qe i menaxhoni përfshirë Institucionet Arsimore dhe Shëndetësore.

41	Shpat Neziri, Kryetar i Forumit Rinor të LDK-së 01-034/01-0035324/26	Elektronike	18.06.2026	19.06.2026	Qasje e Plotë	24.06.2026	Pala ka kërkuar qasje mbi mënyrën e dhënies në shfrytëzim të këtyre hapësirave publike dhe përfitimet që realizon Komuna nga to. Konkretisht; 1.Vendimin për dhënien në shfrytëzim të hapësirave reklamuese në stacionet e autobusëve; 2.Kontratën/kontratat e lidhura me operatorin/operatorët ekonomikë; 3.Procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e operatorit (ftesë publike, tender, negocim, etj.); 4.Afatin e kontratës dhe kushtet e shfrytëzimit; 5.Vlerën financiare të kontratës dhe detyrimet financiare ndaj Komunës; 6.Evidencën e pagesave të realizuara nga operatori (të hyrat për Komunën); 7.Listën e stacioneve të autobusëve të përfshira në kontratë; 8.Çdo vendim të Kuvendit Komunal ose të Kryetarit që lidhet me këtë çështje.
42	Shkëlqim Ibrahimi, Anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës nga radhët e PDK-së 01-034/01-0035547/26	Elektronike	22.06.2026	22.06.2026	Qasje e Plotë	14.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentacionin e plotë lidhur me projektin e konstruksioneve metalike dhe saksive me lule të vendosura në ishujt e qytetit të Mitrovicës; 1.Vendimet për inicimin dhe aprovimin e projektit; 2.Kërkesat, procedurat e prokurimit dhe i gjithë dokumentacioni përcjellës i procedurës; 3.Dosja e tenderit, përfshirë specifikat teknike dhe paramasat/parallogaritë; 4.Procesverbalet, raportet e vlerësimit dhe vendimi për dhënie të kontratës; 5.Kontrata e lidhur me operatorin ekonomik;

							6.Dokumentet mbi mbikëqyrjen, pranimin teknik apo raportet e realizimit të projektit; 7.Faturat, pagesat e realizuara dhe çdo dokument tjetër financiar që lidhet me këtë projekt.
43	Jahir Sumiçi, HulumTime Media, 01-034/01-0037408/26	Elektronike	24.06.2026	01.07.2026	Qasje e Plotë	15.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet si në vijim: 1.Listën e plotë të të gjitha pagesave të realizuara nga nënprogramet buxhetore të Drejtorisë së Arsimit për mbulimin e obligimeve të Drejtorisë së Infrastrukturës, duke përfshirë datën, shumën, përshkrimin e pagesës dhe nënprogramin buxhetor nga i cili janë realizuar. 2.Të gjitha urdhërpagesat, autorizimet e pagesave, voucher-at financiarë dhe dokumentet e tjera financiare që dëshmojnë realizimin e këtyre pagesave. 3.Çdo vendim, shkresë, memorandum, dakordim, procesverbal apo dokument tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është vendosur që obligimet e Drejtorisë së Infrastrukturës të financohen nga buxhetet e nënprogrameve të Arsimit. 4.Dokumentacionin që dëshmon zotimin e përmendur në përgjigjen tuaj, sipas të cilit Drejtoria e Infrastrukturës është zotuar se deri në fund të vitit këto obligime do të mbulohen nga buxheti i Komunës, përkatësisht nga buxhetet e drejtorive komunale përkatëse. 5.Evidencën kontabël ose raportin financiar që tregon ndikimin e këtyre pagesave në buxhetin e secilit nënprogram të Arsimit.
44	Gazmend Morina, Gazetar në Veriu.Info 01-034/01-0037310/26	Elektronike	29.06.2026	01.07.2026	Qasje e Plotë	14.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në; 1) Marrëveshjen/Kontratën mes Komunës së Mitrovicës dhe kompanisë që e ka marr në shfrytëzim këtë pronë. 2) Marrëveshjen/Kontratën me të cilën i është vazhduar afati i shfrytëzimit.

							3) Marrëveshjen/Kontratën apo çfarëdo dokumenti zyrtar me të cilin përcaktohen obligimet e marrësit në shfrytëzim të kësaj prone. 4) Te gjitha shkresat tjera të lëndës që ekzistojnë për këtë rast.
45	Gazmend Morina, Gazetar në Veriu.Info 01-034/01-0037304/26	Elektronike	29.06.2026	01.07.2026	Qasje e Plotë	15.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në: 1) Çdo vendim te inspektoreve për ndërprerje të punimeve në dhe mbi këtë qendër prej 1 janar 2025 e deri me 29 qershor 2026. 2) Çdo vendim për leje për kryerje të punimeve në dhe mbi këtë qendër prej 1 janar 2025 e deri me 29 qershor 2026. 3) Çdo dokumente/shkresë që Komuna e Mitrovicës, përfshirë edhe Drejtorinë për Inspekcion dhe Drejtorinë për Urbanizëm ka LESHUAR për kompaninë që menaxhon këtë qendër prej 1 janar 2025 e deri me 29 qershor 2026.
46	Edona Meholli, Gazetare në Veriu.Info 01-034/01-0037307/26	Elektronike	29.06.2026	01.07.2026	Qasje e Plotë	06.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në këto dokumente: 1) Të gjitha kërkesat për leje ndërtimore të objekteve banesore pranë Liqenit Akumulues në Mitrovicë për periudhën 1 janar 2026 deri me 25 qershor 2026. Pra, gjitha kërkesat pavarësisht statusit te tyre aktual procedural. 2) Vendimet për refuzim apo aprovim të këtyre kërkesave për leje ndërtimore. Këtu fjala është për ato kërkesa që nuk janë në procedure, por është marr vendim aprovues apo refuzues për to.
47	Jahir Sumiçi, HulumTime Media,	Elektronike	30.06.2026	01.07.2026	Qasje e Plotë	03.07.2026	Pala ka kërkuar qasje dhe kopje elektronike të dokumenteve si më poshtë: 1. Të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Tregu" Sh.A. të mbajtura gjatë vitit 2026.

	01-034/01-0037388/26						2. Procesverbalin e mbledhjes në të cilën është shqyrtuar dhe miratuar riemërimi i z. Musa Preteni në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të NPL "Tregu" Sh.A. 3. Vendimin për riemërimin e z. Musa Preteni në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv. 4. Të gjitha materialet përcjellëse që i janë paraqitur Komisionit të Aksionarëve lidhur me këtë riemërim, përfshirë propozimet, raportet, rekomandimet, arsyetimet dhe dokumentet tjera relevante që kanë shërbyer si bazë për vendimmarrje. 5. Listën e pjesëmarrësve dhe nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Aksionarëve në mbledhjen ku është marrë vendimi për riemërimin e z. Musa Preteni. 6. Çdo vendim tjetër të Komisionit të Aksionarëve gjatë vitit 2026 që lidhet me mandatin, kontratën apo vazhdimin e angazhimit të Kryeshefit Ekzekutiv të NPL "Tregu" Sh.A.
48	Arbnora Pllana, gazetare në Kosova Press 01-034/01-0037385/26	Elektronike	01.07.2026	01.07.2026	Qasje e Plotë	07.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në informacione lidhur me gjendjen aktuale të Liqenit Artificial në Mitrovicë. Konkretisht ka kërkuar të përgjigjemi në këto pyetje; A është Komuna e Mitrovicës në dijeni për gjendjen aktuale të Liqenit të Mitrovicës dhe ndotjen e paraqitur në pamjet e publikuara? A është realizuar kontrata e përmendur prej rreth 600 mijë eurosh për pastrimin apo mirëmbajtjen e liqenit? Kush e ka monitoruar zbatimin e kësaj kontrate dhe a janë përmbushur të gjitha obligimet nga operatori ekonomik? Sa ndërhyrje për pastrim të liqenit janë bërë gjatë vitit të fundit dhe kur është kryer pastrimi i fundit në terren?

							A ka Komuna një plan konkret me afate dhe mjete të përcaktuara për sanimin e gjendjes aktuale të Liqenit të Mitrovicës? Nëse po, cilat janë hapat e parë që do të ndërmerren?
49	Fitore Hasani 01-034/01-0038492/26	Elektronike	01.07.2026	03.07.2026	Qasje e Plotë	10.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në disa të dhëna duke iu referuar Vendimit të Komisionit të Ankesave, Nr. Prot. 07-610/01-0027112/26.
50	Jahir Sumiçi, HulumTime Media 01-034/01-0038349/26	Elektronike	03.07.2026	06.07.2026	Qasje e Plotë	14.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentacionin që lidhet me projektin për asfaltimin e rrugëve në fshatin Rashan. Konkretisht, ka kërkuar: 1. Një kopje të kontratës së nënshkruar për realizimin e projektit të asfaltimit të rrugëve në fshatin Rashan, e cila, sipas informacioneve publike, përfshin asfaltimin e rreth 6 kilometrave rrugë. 2. Skicën, hartën, projektin, situacionin ose çdo dokument tjetër zyrtar që tregon saktësisht segmentet rrugore që do të përfshihen në asfaltim në kuadër të kësaj kontrate.
51	Shpat Neziri, Kryetar i Forumit Rinor të LDK-së 01-034/01-0038493/26	Elektronike	06.07.2026	06.07.2026	Qasje e Plotë	14.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentacionin publik që lidhet me projektin e vendosjes së konstruksioneve metalike dhe luleve dekorative në Bulevardin "Shemsi Ahmeti" në Mitrovicë. Dokumentet si në vijim: 1. Vendimi për inicimin dhe realizimin e projektit; 2. Dosja e tenderit dhe specifikimet teknike; 3. Kontrata e nënshkruar me operatorin ekonomik fitues; 4. Paramasa dhe parallogaria e projektit; 5. Projekti ekzekutiv dhe dokumentacioni teknik përcjellës;

							6. Raportet e mbikëqyrjes së punimeve; 7. Procesverbalet e pranimit teknik dhe pranimit përfundimtar; 8. Emri i menaxherit të kontratës dhe vendimi për emërimin e tij; 9. Vlera e kontratës, anekset eventuale dhe pagesat e kryera deri më tani; 10. Çdo dokument tjetër publik që lidhet me planifikimin, prokurimin, realizimin, mbikëqyrjen dhe pranimin e këtij projekti
52	Jahir Sumiçi, HulumTime Media 01-034/01-0039141/26	Elektronike	07.07.2026	08.07.2026	Qasje e Plotë	15.07.2026	Pala ka kërkuar qasje dhe kopje të dokumenteve në vijim, që lidhen me ndryshimet në udhëheqjen e SHFMU "Skënderbeu" në Vaganicë: 1. Vendimin për shkarkimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit, Behar Xhosha. 2. Arsyetimin zyrtar dhe dokumentacionin përkatës mbi bazën e të cilit është marrë vendimi për shkarkimin e tij. 3. Vendimin për emërimin e Emine Beqiri Peci si ushtruese e detyrës së drejtoreshës së SHFMU "Skënderbeu" në Vaganicë. 4. Çdo dokument përcjellës (propozim, rekomandim, procesverbal, shkresë zyrtare apo akt tjetër administrativ) që ka shërbyer si bazë për marrjen e vendimeve të lartpërmendura.
53	Urall Boshnjaku, Redaksia e Mitropol Media 01-034/01-0040132/26	Elektronike	13.07.2026	13.07.2026	Qasje e Pjesshme	17.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në listën e personave të pranuar për pune praktike për të cilët kryetari Faton Peci njoftoi me 1 korrik, si dhe kërkoj të kem qasje ne dokumentacionin e plotë të kritereve për vlerësim/pranim në punë.
54	Shpat Neziri,	Elektronike	13.07.2026	13.07.2026	Qasje e Plotë	16.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentacionin zyrtar që ndërlidhet me projektin e realizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht

	Kryetar i Forumit Rinor të LDK-së 01-034/01-0040139/26						zëvendësimin e fotografisë bardh e zi të Heroit Isa Boletini me versionin me ngjyra. Në mënyrë të veçantë, kërkoj që të më vihen në dispozicion këto dokumente: 1. Vendimi administrativ ose akti përkatës për inicimin dhe realizimin e projektit; 2. Kërkesa iniciuese dhe arsyetimi përkatës i projektit; 3. Specifikimet teknike të punimit; 4. Vlera e përgjithshme financiare e projektit; 5. Kontrata e lidhur me operatorin ekonomik, nëse është angazhuar një i tillë; 6. Faturat, urdhër-pagesat dhe dokumentet që dëshmojnë ekzekutimin e pagesave; 7. Shpallja e tenderit, ftesa për kuotim ose çdo formë tjetër e procedurës së prokurimit të përdorur për përzgjedhjen e operatorit ekonomik; 8. Lista e operatorëve ekonomikë që kanë aplikuar ose janë ftuar të ofertojnë; 9. Vendimi për dhënien e kontratës dhe raporti i vlerësimit të ofertave; 10. Emrat e personave përgjegjës për inicimin, aprovimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të projektit.
55	Urall Boshnjaku, Redaksia e Mitropol Media	Elektronike	14.07.2026	14.07.2026	Qasje e Plotë	30.07.2026	Pala ka kërkuar qasje të plotë në dokumentacionin e shpalljes së OJQ-ve fituese në fushën e sportit të shpallur me 6 korrik 2026, si dhe shumën specifike të aprovuar për secilën veç e veç.

	01-034/01-0040529/26						
56	Valbona Bytyqi, Gazetare në Radio Evropa e Lirë 01-034/01-0041087/26	Elektronike	15.07.2026	15.07.2026	Qasje e Plotë	31.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në informacionet dhe të dhënat e kërkuara përmes pyetjeve të mëposhtme: 1.Sa hektarë komunale administron komuna? Sa prej kësaj prone është: tokë bujqësore; tokë ndërtimore; hapësirë publike; pronë tjetër? 2.Sa hektarë janë të dhënë me qira? Sa kontrata aktive të qirasë ka komuna? 3.Kush janë përfituesit kryesorë të hapësirave komunale të dhëna me qira? Ju lutem na ofroni listën e tyre? 4.Sa të hyra ka realizuar komuna nga qiratë gjatë pesë viteve të fundit (sipas viteve)? 5.Sa prona komunale nuk shfrytëzohen aktualisht. Ju lutem na ofroni hollësi rreth tyre, si sipërfaqen, lokacionin, vlerën nëse është e disponueshme. 6.Cilat janë planet e komunës për aktivizimin e pronës publike? 7.Cilat janë sfidat kryesore në menaxhimin e pronës komunale? 8.Cili është raporti që komuna juaj ka me nivelin qendror për administrimin e pronës publike apo edhe për aktivizimin e saj?
57	Aurora Tafili, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale 01-034/01-0041088/26	Elektronike	15.07.2026	15.07.2026	Anuluar		Pala ka kërkuar qasje në informacione publike – Monitorimi i të drejtave të fëmijëve në nivel lokal

58	Jahir Sumiçi, HulumTime Media 01-034/01-0041769/26	Elektronike	20.07.2026	20.07.2026	Tërhequr Pala ka tërhequr me dëshirën e tij kërkesën me datë 20.07.2026		Pala ka kërkuar qasje në të gjitha dokumentet publike që lidhen me procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për programin e praktikës me pagesë për të rinjtë në Komunën e Mitrovicës. Konkretisht, ka kërkuar t'i dërgohen në formë elektronike këto dokumente: • Lista përfundimtare e kandidatëve të pranuar për praktikë me pagesë; • Procesverbalet e plota të Komisionit Përzgjedhës; • Vendimet e Komisionit Përzgjedhës; • Formularët e vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat; • Tabelat e pikëzimit dhe rezultatet përfundimtare; • Dokumentet që përmbajnë arsyetimin e përzgjedhjes së kandidatëve; • Të gjitha dokumentet zyrtare të hartuara gjatë këtij procesi administrativ; • Çdo akt, raport, evidencë, procesverbal, listë prezence, nënshkrim apo dokument tjetër zyrtar që lidhet me punën dhe vendimmarrjen e Komisionit Përzgjedhës.
59	Eriona Xhakolli, Gazetare në ATV 01-034/01-0043038/26	Elektronike	22.07.2026	24.07.2026	Qasje e Plotë	30.07.2026	Pala ka kërkuar qasje lidhur me aktivitetet që komuna ka organizuar për mërgatën gjatë verës 2026: • Sa është buxheti i ndarë për aktivitetet e mërgatës gjatë këtij viti? • Sa mjete janë shpenzuar deri më tani dhe për cilat aktivitete konkrete? • Kush e ka marrë vendimin për ndarjen e këtij buxheti dhe mbi çfarë kriteresh është bazuar? • A janë zhvilluar procedura të prokurimit publik për organizimin e këtyre aktiviteteve? Nëse po, cilat kompani janë kontraktuar dhe sa është vlera e kontratave?

							• Si e mat komuna efektin e këtyre aktiviteteve dhe a ka ndonjë raport apo vlerësim mbi rezultatet e tyre? • Duke pasur parasysh nevojat në fusha të tjera si infrastruktura, arsimi apo shëndetësia, si e arsyeton komuna këtë nivel shpenzimi për aktivitetet e mërgatës? • A konsideroni se fondet e ndara për këto aktivitete kanë sjellë përfitime konkrete për qytetarët dhe mërgimtarët? Nëse po, cilat janë ato?
60	Urall Boshnjaku, Redaksia e Mitropol Media 01-034/01-0043579/26	Elektronike	24.07.2026	28.07.2026	Qasje e Plotë	31.07.2026	Pala ka kërkuar qasje dhe informacione nga Drejtoria e Urbanizmit në lidhje me të gjitha lejet e lëshuara në periudhën 7 mujore (janar-korrik) për ndërtime të larta mbi 3 katëshe në zonën e qendrës, duke përfshirë lagjen Ilirida dhe të gjitha lagjet e qendrës së qytetit (Nexhip Dragaj, Ferat Dragaj, Ali Zeneli, Mbretëresha Teutë, si dhe tek Liqeni Artificial).
61	Jahir Sumiçi, HulumTime Media 01-034/01-0043037/26	Elektronike	23.07.2026	24.07.2026	Qasje e Plotë	11.08.2026	Pala ka kërkuar qasje dhe kopje të dokumenteve publike që kanë të bëjnë me procesin e subvencionimit për 639 qytetarët, për të cilët Drejtoria për Shëndetësi ka njoftuar se janë ekzekutuar mjete financiare në vlerë prej 74,000.00 euro për mbulimin e shpenzimeve për barna dhe trajtime mjekësore. Kërkoj që të më vihen në dispozicion këto dokumente: 1.Vendimi për ndarjen e subvencioneve. 2.Thirrja publike, nëse është publikuar. 3.Rregullorja, udhëzimi administrativ ose baza ligjore mbi të cilën është zhvilluar procesi. 4.Të gjitha procesverbalet e komisionit përgjegjës. 5.Vendimi për emërimin e komisionit vlerësues. 6.Lista e anëtarëve të komisionit.

							7.Raporti i komisionit vlerësues. 8.Tabela e vlerësimit për secilin aplikues. 9.Lista e plotë e aplikuesve. 10.Lista e përfituesve me shumën e përfituar për secilin. 11.Lista e aplikuesve të refuzuar, së bashku me arsyet e refuzimit. 12.Kriteret e vlerësimit dhe mënyra e pikëzimit të aplikimeve. 13.Të gjitha vendimet për aprovimin ose refuzimin e kërkesave. 14.Dokumentacioni financiar që dëshmon ekzekutimin e shumës prej 74,000.00 euro. 15.Çdo raport përfundimtar ose dokument tjetër zyrtar që lidhet me këtë proces.
62	Fatos Voca 01-034/01-0043877/26	Fizike	29.07.2026	30.07.2026	Qasje e Pjesshme	31.07.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente publike lidhur me shërbimet e prindërimit që ofron Qendra për Punë Sociale.
63	Shpat Neziri, Kryetar i Forumit Rinor të LDK-së 01-034/01-0044759/26	Elektronike	01.08.2026	03.08.2026	Qasje e Plotë	05.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentacionin zyrtar që lidhet me kontratën e nënshkruar për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në Komunën e Mitrovicës. Konkretisht, kërkoj qasje në: • Kontratën e nënshkruar me operatorin ekonomik. • Dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike. • Vendimin për dhënien e kontratës. • Raportin e vlerësimit të ofertave.

							• Njoftimin për kontratë dhe njoftimin për dhënie të kontratës. • Vlerën e kontratës dhe kohëzgjatjen e saj. • Planin e mirëmbajtjes dhe zonat që përfshihen në kontratë, nëse janë pjesë e dokumentacionit. • Emrin e operatorit ekonomik fitues dhe dokumentacionin publik që lidhet me procedurën e prokurimit.
64	Shpat Neziri, Kryetar i Forumit Rinor të LDK-së 01-034/01-0044761/26	Elektronike	01.08.2026	03.08.2026	Qasje e Plotë	05.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në kontratën e nënshkruar për trajtimin e qenve endacakë në Komunën e Mitrovicës. • Kontratën e nënshkruar me operatorin ekonomik. • Dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike. • Vendimin për dhënien e kontratës. • Raportin e vlerësimit të ofertave. • Njoftimin për kontratë dhe njoftimin për dhënie të kontratës. • Vlerën totale të kontratës dhe kohëzgjatjen e saj. • Planin operacional të zbatimit të kontratës, nëse ekziston. • Emrin e operatorit ekonomik fitues dhe dokumentacionin publik që lidhet me procedurën e prokurimit.
65	Aurora Tafili, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale 01-034/01-0044764/26	Elektronike	03.08.2026	03.08.2026	Qasje e Plotë	10.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në informacione publike që kanë të bëjnë me Monitorimin e të drejtave të fëmijëve në nivel lokal.

66	Gazeta Rajoni 01-034/01-0046938/26	Elektronike	11.08.2026	11.08.2026	Qasje e Plotë	11.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike në kontratën e re "Trajtimi qenve endacak që bredhin lirshëm në Komunën e Mitrovicës".
67	KF-"FC Mitrovica" 01-034/01-0048326/26	Elektronike	13.08.2026	13.08.2026	Qasje e Plotë	19.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në opinionin dhe sqarimin zyrtar të Zyrës së Sekretariatit të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, lidhur me çështjen e dhënies në shfrytëzim të Stadiumit "Xhevat Jusufi – Xheki" për OJQ KF Mitrovica (Australia), si dhe dhënies në shfrytëzim të tokës për OJQ KF Trepça, për qëllime të ndërtimit të fushave sportive.
68	Gazmend Mustafa, Përfaqësues i bizneseve NEWCO LUX SUPERMARKET L.L.C DHE EUROMARKET SH.P.K 01-034/01-0046593/26	Fizike	10.08.2026	10.08.2026	Qasje e Plotë	31.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me N.P.L Stacioni i Autobusëve Sh.A- Mitrovicë, Kontratën nr. 112/23 të datës 30.06.2023 me Arjeta Group Sh.P.K pronën/ hapësirat përreth, punimet, parkingun, rampën dhe qasjen në pronën e tij.
69	Enis Veliu, Gazetar në Front Online Sh.P.K 01-034/01-0046687/26	Elektronike	10.08.2026	10.08.2026	Qasje e Plotë	31.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në; 1.Listën e plotë te të gjitha objekteve për të cilat Inspektorati i Komunës së Mitrovicës ka konstatuar ndërtim pa leje ose tejkalim të lejes ndërtimore gjatë periudhës 1 janar 2025 – 31 korrik 2026, duke përfshirë lokacionin, investitorin/pronarin dhe shkeljen e konstatuar ? 2.Kopjet e të gjitha vendimeve për rrënim të objekteve pa leje ose pjesëve të ndërtuara në kundërshtim me lejen ndërtimore gjatë periudhës 1 janar 2025 deri më 31 korrik 2026, si dhe statusin aktual të ekzekutimit të secilit vendim ?

							3. Listën e të gjitha rasteve ku Inspektorati ka shqiptuar gjoba për ndërtime pa leje ose tejkalim të lejes, duke përfshirë shumën e gjobës, datën e shqiptimit, subjektin ndaj të cilit është shqiptuar dhe informacionin nëse gjoba është paguar? 4. Listën e të gjitha rasteve të ndërtimeve pa leje ose tejkalimeve të lejes për të cilat është nxjerrë vendim inspektues, por vendimi ende nuk është ekzekutuar, duke përfshirë datën e vendimit, arsyen e mosekzekutimit dhe veprimet që Komuna ka ndërmarrë deri më tani?
70	Agnesa Qorri, Gazetare Hulumtuese në BIRN Kosova 01-034/01-0046556/26	Elektronike	10.08.2026	10.08.2026	Qasje e Plotë	26.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në investimet publike për parandalimin e vërshimeve, rregullimin e lumenjve dhe rehabilitimin pas përmbytjeve, me fokus në efektivitetin e këtyre investimeve, prokurimin publik dhe llogaridhënien institucionale.
71	Shpetim Lajqi, Ekspert Gjyqësor-lëmia e Makinerisë 01-034/01-0046587/26	Elektronike	10.08.2026	10.08.2026	Qasje e Plotë	31.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në çështjen juridiko-kontestimore ndërmjet N.P. "KO-MED" (Arben S. Ismajli B.I.) dhe Komunës së Mitrovicës.
72	Redaksia e Veriu.Info 01-034/01-0048330/26	Elektronike	16.08.2026	17.08.2026	Refuzohet pjesërisht	21.08.2026	Pala ka kërkuar qasje në aktivitetin e prokurimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut me titull "Mirëmbajtja, ngritja dhe revitalizimi i sipërfaqeve të gjelbëruara në parqe të qytetit dhe hapësira publike", me numër të prokurimit 642-26-6732-2-2-1.
73	Jahir Sumiçi,	Elektronike	17.08.2026	18.08.2026	Qasje e Plotë	07.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente dhe informacione publike lidhur me shfrytëzimin, zënien dhe zgjerimin e hapësirave publike – trotuareve,

	HulumTime Media 01-034/01-0048654/26						shesheve dhe hapësirave të tjera publike – nga subjektet afariste, veçanërisht lokalet e gastronomisë, në territorin e Komunës së Mitrovicës.
74	Safete Musa 01-034/01-0051389/26	Elektronike	27.08.2026	28.08.2026	Qasje e Plotë	02.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në kopjen e plotë të: Rregullores mbi rendin shtëpiak dhe normat e përgjithshme të sjelljes, nr. 460, datë 05.10.2022", të QKMF-së "Dr. Nexhat Çuni" – Mitrovicë.
75	OJQ "EC Ma Ndryshe" 01-034/01-0051383/26	Elektronike	27.08.2026	28.08.2026	Qasje e Plotë	02.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata si dhe në dokumente rreth inspektimeve të realizuara në Komunën e Mitrovicës së Jugut për periudhën kohore janar-qershor 2026. • Numri i inspektimeve mjedisore? • Numri i inspektorëve mjedisor? • Numri i gjobave mjedisore të shqiptuara? • Numri i lejeve mjedisore të lëshuara gjatë periudhës janar-qershor 2026?
76	Shpat Neziri, Kryetar i Forumit Rinor të LDK-së 01-034/01-0052153/26	Elektronike	28.08.2026	01.09.2026	Qasje e Plotë	02.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentin me referencë 02-352/01-0021964/26, të datës 20.04.2026, me titull "Propozim-vendim për vendosjen e pllakës përkujtimore Heroit Driton Veliu."
77	Gazmend Mustafa, Pronar/Përfaqësues i bizneseve NEWCO LUX	Fizike	02.09.2026	03.09.2026	Qasje e Plotë	08.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike që ndërlidhet me kërkesën e tij paraprake Nr. 01-034/01-0046593/26, që ka të bëj me NPL "Stacioni i Autobusëve", në Mitrovicë dhe ndërhyrjet e realizuara në hapësirat përreth pronës së tij private.

	SUPERMARKET L.L.C DHE EUROMARKET SH.P.K 01-034/01-0052473/26						
78	Blerim Carani 01-034/01-0055731/26	Fizike	18.09.2026	18.09.2026	Qasje e Pjesshme	21.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentacionin relevant të kandidates së përzgjedhur, konkretisht kualifikimin, përvojën e punës, pikët/vlerësimin dhe dokumentet tjera relevante të përdorura gjatë procedurës së rekrutimit.
79	Iset Beka 01-034/01-0055884/26	Elektronike	21.09.2026	21.09.2026	Qasje e Pjesshme	25.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet publike që lidhen me procedurën e përzgjedhjes për pozitat Drejtor/e dhe Zv. Drejtor/e në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Arsimit Parauniversitar (IEAA-AP), për konkursin e publikuar më 06.07.2026, me numër reference 01-111/01-0034812-2/26, për të cilin Komuna e Mitrovicës së Jugut ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me 18.09.2026.
80	Arif Kadriu 01-034-01-0056525/26	Elektronike	23.09.2026	23.09.2026	Qasje e Plotë	25.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike konkretisht; 1. Versionin përfundimtar të miratuar të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Mitrovicën e Jugut për periudhën 2023–2028, përfshirë planin e veprimit; 2. Vendimin e Kuvendit Komunal për miratimin e këtij plani; 3. Raportet vjetore për zbatimin e planit, nëse janë përgatitur.
81	Ajmane Barani 01-111/01-0057015/26	Fizike	25.09.2026	01.10.2026 Është pranuar në formë fizike në Zyrën për	Në proces		Pala ka kërkuar qasje në dokumente që kanë të bëjnë me konkursin për pozitën Zëvendësdrejtor në shkollën Gjimnazi "Frang Bardhi".

				Komunikim me Publikun			
82	Jahir Sumiçi 01-034/01-0057079/26	Elektronike	28.09.2026	28.09.2026	Në proces		Pala ka kërkuar qasje në të dhënat për secilën veç e veç nga të gjitha QKMF-të, AMF-të (Ambulancat e Mjekësisë Familjare) dhe njësitë e tjera të mjekësisë familjare që funksionojnë në kuadër të Komunës së Mitrovicës. Për secilin institucion kërkoj këto të dhëna: 1.Numrin e pozitave të parapara/sistematizuara për secilin profil shëndetësor; 2.Numrin e stafit aktualisht të angazhuar/punësuar; 3.Numrin e pozitave të paplotësuara, përkatësisht mungesat e stafit; 4.Emërtimin e pozitave/profesioneve që mungojnë, si: mjek i mjekësisë familjare, pediatër, stomatolog, infermier/e, teknik/e, gjinekolog dhe profile të tjera shëndetësore të parapara për atë institucion; 5.Kopjen ose pjesën përkatëse të aktit të sistematizimit ku përcaktohet numri i pozitave për secilën njësi; 6.Për pozitat e paplotësuara, informacion nëse është hapur konkurs, është planifikuar rekrutimi apo është ndërmarrë ndonjë procedurë tjetër për plotësimin e tyre, si dhe statusin e kësaj procedure.
83	Besiana Jashari 01-034/01-0057383/26	Elektronike	29.09.2026	29.09.2026	Qasje e Plotë	30.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në testin e saj, përgjigjet e dhëna dhe pikët e fituara në test.
84	Leonora Januzi 01-034/01-0057279/26	Elektronike	29.09.2026	29.09.2026	Qasje e Plotë	30.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në testin e saj, përgjigjet e dhëna dhe pikët e fituara në test.

85	Donika Zenullahu 01-034/01-0057356/26	Elektronike	29.09.2026	29.09.2026	Qasje e Plotë	30.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në testin e saj, përgjigjet e dhëna dhe pikët e fituara në test.
86	Rinesa Salihu 01-034/01-0057380/26	Elektronike	29.09.2026	29.09.2026	Qasje e Plotë	30.09.2026	Pala ka kërkuar qasje në testin e saj, përgjigjet e dhëna dhe pikët e fituara në test.
87	Igballe Islami 01-034/01-0057579/26	Fizike	30.09.2026	01.10.2026 Është pranuar në formë fizike nga Zyra për Komunikim me Publikun	Në proces		Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me planifikimin buxhetor për periudhën 2027-2029 dhe procedurën e prokurimit për ndërtimin e çerdheve në Kçiq të Madh dhe në lagjen Ura e Gjakut/ Vaganicë.

Vërejtje:

Të gjitha kërkesat e parashtruara si nga gazetarë, shoqëri civile, organizata buxhetore, individ, studentë apo të tjerë janë të arkivuara si dokumente fizike dhe dokumente elektronike.

Sofije Rushiti- Peci

Zyrtare Përgjegjëse për Qasje në Dokumente Publike në Komunën e Mitrovicës



02/10/2026